




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office



Nr. protokollit 288  
Me datë: 31.07.2017  
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

- I. Formohet komisioni i përbashkët mes Komunës së Rahovecit dhe KRU- Radoniq për pranimin-dorëzimin teknik të Ujësllësit në fshatin Guri i Kuqë dhe Polluzhë, në përbërje prej:
  1. Venhar Topalli, Kryesues
  2. Bilall Karadollami, anëtar KRU- Radoniq
  3. Gazmend Dinarama, anëtar KRU -Radoniq
- II. Komisioni ka për detyrë që të bëjë pranimin teknik të punëve të kryera sipas Projektit “Ndërtimi i Sistemeve të ujësllësit në Komunën e Rahovecit për Fshatrat Guri i Kuq dhe Polluzhë”.
- III. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në kontratën ekzistuese me numër prokurimi 623.16.040.521 dhe legjislacionin aktual në fuqi .
- IV. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit, Drejtoria për Shërbime Publike.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

*Me vendim të njoftohen:*

1. Anëtarët e komisionit,
2. Zyra e Prokurimit,
3. Drejtoria për Shërbime Publike, dhe
4. Arkivi





Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office

Nr. i protokollit 283  
Me datë: 19.07.2017  
Rahovec


Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**  
**KOMISIONI PËR PRANIMIN E SHËRBIMEVE PROFESIONALE PËR**  
**VLERESIMIN E PRONAVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**

- I. Formohet komisioni për pranimin e shërbimeve për vlerësimin e pronave në Komunën e Rahovecit me Nr. Prokurimi : 623.17.034.247 , në përbërje :
  1. Muj Hundozi , Kryesues
  2. Gjyle Gashi, anëtare
  3. Reshat Shehu , anëtarë
- II. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e shërbimeve profesionale për vlerësimin e pronave në komunën e Rahovecit .
- III. Obligohet komisioni që këto punët ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
- IV. Komisioni do të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij Vendimi dhe punët duhet të përfundoj në një afatë të arsyeshëm .
- V. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

*Me Vendim të njoftohen:*

1. Anëtar të komisionit
2. Drejtorja për Buxhet dhe Financa
3. Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës - Preседnik Opštine - Mayor Office



Nr. protokollit 295  
Me datë: 26.07.2017  
Rahovec


Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 35 të Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L042, nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Me të cilin lejohen punët shtesë në projektin “Punimi i Muralit në ndërtesën në Qendër të qytetit”, në vlerë prej 848.00€ (Tetëqind e dyzetë e tetë euro).
- II. Ky vendim merret, pasi që është konstatuar nga organi mbikëqyrës dhe menaxheri i Projektit, se projekti është në fazën përfundimtare dhe për tu funksionalizuar është e nevojshme që të jepen edhe këto mjete shtesë.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Zyra e prokurimit, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

*Me vendim të njoftohen:*

1. Zyra e Prokurimit,
2. DUPMM, dhe
3. Arkivi





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office



Nr. protokollit 294  
Me datë: 26-07-2017  
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 35 të Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L042, nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Me të cilin lejohen punët shtesë në projektin “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Drenoc- Zatriq”, në vlerë prej 34.242.21€ (Tridhjetë e katër mijë e dyqind e dyzet e dy euro e njëzet e një cent euro).
- II. Ky vendim merret, pasi që është konstatuar nga organi mbikëqyrës dhe menaxheri i Projektit, se projekti është në fazën përfundimtare dhe për tu funksionalizuar është e nevojshme që të jepen edhe këto mjete shtesë.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Zyra e prokurimit, Drejtoria për Shërbime Publike.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

*Me vendim të njoftohen:*

1. *Zyra e Prokurimit,*
2. *Drejtoria për Shërbime Publike, dhe*
3. *Arkivi*





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office

Nr. protokollit 272  
Me datë: 11.07.2017  
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr 1005 i datës 29.03.2017, nenit 4 par. 4 dhe nenit 21 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve me nr.1427 e datës 28.04.2017 Kryetari i Komunës, merr:

**VENDIM**

- I. Me të cilin miratohet kërkesa e **Idriz Kastratit** nga fshati Nashpall, Komuna e Rahovecit, me Nr.prot. 1850 e datës 09.06.2017 për ndihmë momental.
- II. **Idriz Kastratit** i ndahet shuma prej **150.00 €** ( njëqind e pesëdhjetë euro), shumë të cilën ai do ta shfrytëzojë për trajtimin e sëmundjes, pasi që i njëjti jeton në kushtet të rënda ekonomike.
- III. Ky vendim merret me qëllim të ofrimit të ndihmës, qytetarit në nevojë.
- IV. Mjetet do të sigurohen nga kodi i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


*Me vendim të njoftohen:*

1. *Idriz Kastrati,*
2. *Drejtoria për Buxhet dhe Financa,*
3. *Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,*
4. *Arkivi.*





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office

Nr. protokollit 274  
Me datë: 11.07.2017  
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr 1005 i datës 29.03.2017, nenit 4 par. 4 dhe nenit 21 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve me nr.1427 e datës 28.04.2017 Kryetari i Komunës, merr:

**VENDIM**

- I. Me të cilin miratohet kërkesa e **Jalldëze Dërmala** nga Rahoveci, me Nr.prot. 2034 e datës 04.07.2017 për ndihmë momental.
- II. **Jalldëze Dërmalës** i ndahet shuma prej 400.00 € ( katërqind euro), shumë të cilën ajo do ta shfrytëzojë për trajtimin e sëmundjes, pasi që e njehta jeton në kushtet të rënda ekonomike.
- III. Ky vendim merret me qëllim të ofrimit të ndihmës, qytetarit në nevojë.
- IV. Mjetet do të sigurohen nga kodi i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


*Me vendim të njoftohen:*

1. *Jalldëze Dërmala,*
2. *Drejtoria për Buxhet dhe Financa,*
3. *Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,*
4. *Arkivi.*





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office

Nr. protokollit 275  
Me datë: 19.07.2017  
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr 1005 i datës 29.03.2017, nenit 4 par. 4 dhe nenit 21 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve me nr.1427 e datës 28.04.2017  
Kryetari i Komunës, merr:

**VENDIM**

- I. Me të cilin miratohet kërkesa e **Myrtezan Tara** nga Rahoveci, me Nr.prot. 1384 e datës 27.04.2017 për ndihmë momental.
- II. **Myrtezan Tarës** i ndahet shuma prej **70.00 €** ( Shtatëdhjetë euro), shumë të cilën ai do ta shfrytëzojë për trajtimin e sëmundjes, pasi që i njëjti jeton në kushtet të rënda ekonomike.
- III. Ky vendim merret me qëllim të ofrimit të ndihmës, qytetarit në nevojë.
- IV. Mjetet do të sigurohen nga kodi i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


*Me vendim të njoftohen:*

1. **Myrtezan Tara,**
2. **Drejtoria për Buxhet dhe Financa,**
3. **Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
4. **Arkivi.**





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office

Nr. protokollit 276  
Me datë: 11.07.2017  
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr 1005 i datës 29.03.2017, nenit 4 par. 4 dhe nenit 21 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve me nr.1427 e datës 28.04.2017 Kryetari i Komunës, merr:

**VENDIM**

- I. Me të cilin miratohet kërkesa e **Fetije Thaqi** nga fshati Krushë e Madhe, komuna e Rahovecit, me Nr.prot. 849 e datës 20.03.2017 për ndihmë momental.
- II. **Fetije Thaqit** i ndahet shuma prej 150.00 € (një qind e pesëdhjetë euro), shumë të cilën ajo do ta shfrytëzojë për trajtimin e sëmundjes, pasi që e njëjta jeton në kushtet të rënda ekonomike.
- III. Ky vendim merret me qëllim të ofrimit të ndihmës, qytetarit në nevojë.
- IV. Mjetet do të sigurohen nga kodi i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

*Me vendim të njoftohen:*


1. *Fetije Thaqi,*
2. *Drejtoria për Buxhet dhe Financa,*
3. *Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,*
4. *Arkivi.*







REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office

Nr. protokollit 282  
Me datë: 18.07.2017  
Rahovec

Në bazë të nenit 13, nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, nenit 11 dhe 12 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve me nr.18/30 e datës 07.05.2013 Kryetari i Komunës, merr:

**VENDIM**

- I. Me të cilin miratohet kërkesa e Xhyzide Krasniqi nga fshati Pastaseli komuna e Rahovecit, me Nr. 1567, e datës 16.07.2017 për ndihmë momentale.
- II. **Xhyzide Krasniqi** i ndahet shuma prej 150.00 € (njëqind e pesëdhjetë euro), shumë të cilën ai do ta shfrytëzojë për mbulimin e nevojave familjare.
- III. Ky vendim merret me qëllim të ofrimit të ndihmës, qytetarit në nevojë.
- IV. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

*Me vendim të njoftohen:*

1. *Xhyzide Krasniqi,*
2. *Drejtoria për Buxhet dhe Financa,*
3. *Arkivi.*





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office



Nr. protokollit 288  
Me datë: 21.07.2017  
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 63 dhe 92 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, nenit, 4 paragrafi 4, neni 21 paragrafi 2 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Miratohet Kërkesa me numër 2183 e datës 17.07.2017, e **Hidajete Sharku** nga Rahoveci dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej 150.00 € (Njëqind e pesëdhjetë euro).
- II. Mjetet të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


*Me vendim të njoftohen:*

1. *Hidajete Sharku,*
2. *Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe*
3. *Arkivi*





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office



Nr. protokollit 292  
Me datë: 25.07.2017  
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 63 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, nenit, 4 paragrafi 4, neni 21 paragrafi 2 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Kërkesa me numër 2216 e datës 20.07.2017, e **Mirlinda Fejzulla** nga fshati Celinë dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej 100.00 € (Njëqind euro).
- II. Mjetet të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


*Me vendim të njoftohen:*

1. **Mirlinda Fejzulla**,
2. **Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe**
3. **Arkivi**





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office



Nr. protokollit 293  
Me datë: 25.07.2017  
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 63 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, nenit, 4 paragrafi 4, neni 21 paragrafi 2 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Miratohet Kërkesa me numër 2231 e datës 20.07.2017, e **Stena I Hoxha** nga Rahoveci dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej 100.00 € (Njëqind euro).
- II. Mjetet të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Me vendim të njoftohen:*

1. *Stena I Hoxha,*
2. *Drejtorja për Buxhet dhe Financa, dhe*
3. *Arkivi*





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec  
Drejtoria për Arsim  
Odeljenje za Obrazovanje

Drejtoria për Arsim  
Odeljenje za Obrazovanje  
Department for Education

-IV- Nr. i prot. 07/130 Më 12.07.2017  
Br. prot. Dt. 2017  
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 8, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-032, të datës 29.08.2011, Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Nr.03/L-068, neni 5, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it me nr.08//2014 dhe interferencave të komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec merr këtë:


## VENDIM

Për anulimin e konkursit me nr.07/693, të datës 07.06.2017, të shpallur nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec për pozitën drejtor në SHUM"Faik Sylka" në Rahovec, si dhe të pozitës Zv drejtor në SHFMU"Isa Boletini" në Rahovec.

### Arsyetim:

Për marrjen e këtij vendimi Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, ka qenë e obliguar nga rekomandimet e komisionit të caktuar për kontrollimin e dokumenteve të aplikimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve. Komisioni ka vlerësuar se ka pas parregullësi dhe dyshime në certifikatat për Udhëheqje Arsimore, vërtetuar edhe me reagimin e zyrtares së MASHT-it për KSHLM. Kurse për pozitën Zv. drejtor në SHFMU"Isa Boletini" nuk ka pas kandidat të mjaftueshëm sipas kërkesës së konkursit me nr.07/693, të datës ,07.06.2017.

Rahovec më, 12.07.2017



Vjollca Vuçitërna, Drejtoreshë



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office



Nr. protokollit 277  
Me datë: 11.07.2017  
Rahovec


Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 4 paragrafi 4 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me nr.1427 të datës 28.04.2017 nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M

- I. Miratohet kërkesa me Nr. 2076 e datës 07.07.2017, e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dega Rahovec dhe i lejohen mjetet financiare prej 400 € ( katër qind euro) për kryerjen e përgatitjeve për mbajtjen e manifestimit të „ Epopeja e Rahovecit 17 Korriku “
- II. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

*Me Vendim të njoftohen:*

1. OVL-UÇK-së dega në Rahovec
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe
3. Arkivi





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipal Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office



Nr. protokolit 267  
Me datën: 10.07.2017  
Rahovec

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 040 nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë :

## V E N D I M

- I. Formohet komisioni për pranimin teknik të punimeve sipas kontratës “Ndërtimi i Ambulancës së Mjekësisë Familjare në fshatin Radoste” me nr. të prokurimit 623.16.019.521, në përbërje:
  1. Venhar Topalli - Kryesues
  2. Fadil Bugari - anëtar
  3. Qazim Cana - anëtar
- II. Komisioni ka për detyrë të bëjë pranimin teknik të punimeve sipas kontratës të cekur në pikën I të këtij vendimi.
- III. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij Vendimit.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit .

*Me Vendim të njoftohen :*

1. Anëtar të komisionit
2. DSHPS
3. Arkivi





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office

Nr. protokollit 264  
Me datë: 04.07.2017  
Rahovec


Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 8 të Ligjit të punës Nr.03/L-212 si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës bie këtë:

**VENDIM**

- I. Me këtë vendim formohet Komisioni i rekrutimit për të zhvilluar procedurën e rekrutimit për vendet e punës Drejtorë dhe Zëvendës Drejtor, pran Drejtorisë Komunale të Arsimit, sipas konkursit të publikuar 07/693 të datës 07.06.2017 për këto vende pune:
1. SHFMU "4 Dëshmorët" në Ratkoc
  2. SHML "Ukshin Hoti" në Krushë të madhe
  3. SHUM "Faik Sylka" në Rahovec
- II. Zëvendës Drejtor në :
1. SHFMU "Isa Boletini" në Rahovec,
- Në këtë përbërje:
1. Nexhat Duraku - kryesues
  2. Brikena Osa – anëtare
  3. Fetah Kosumi – anëtar, përfaqësues I MASHT
- III. Detyrat e komisionit janë zhvillimi I procedurave të rekrutimit për përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm konform Udhëzimit administrative të MASHT-it nr. 08/2014 të dt. 25.02.2014 për përzgjedhjen e Drejtorit të Shkollës.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni.
- V. Me vendim të njoftohet komisioni, Udhëheqësi I personelit si dhe arkiva.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.







Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office

Nr. i protokollit 270  
Me datë: 11 - 07.2017  
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**

**KOMISIONI PËR VERIFIKIMIN E OBLIGIMEVE TË PA PAGUAR A NË TAKSA PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË TË SUBJEKTEVE AFARISTE KOMUNALE**

- I. Formohet komisioni për verifikimin e obligimeve të pa paguara në taksa për ushtrimin e veprimtarisë të subjekteve afariste komunale pasive dhe aktive nga 01.01.2001 deri me 31.12.2015 , në përbërje :
  1. Fidan Hoti , Kryesues
  2. Afrim Limani , anëtarë
  3. Gjyle Gashi , anëtare
- II. Komisioni ka për detyrë që të bëjë konstatimin e obligimeve të pa paguara në taksa për ushtrimin e veprimtarisë afariste komunale pasive dhe aktive nga 01.01.2001 deri me 31.12.2015 .
- III. Obligohet komisioni që këto punët ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
- IV. Komisioni do të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij Vendimi dhe punët duhet të përfundoj në një afatë të arsyeshëm .
- V. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

*Me Vendim të njoftohen:*

1. Anëtar të komisionit
2. Drejtoria për Ekonomi , Zhvillim dhe Turizëm
3. Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office



Nr. protokollit 269  
Me datë: 10.03.2017  
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të prokurimit publik, nenit 37 i Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurimin publik, nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

- I. Formohet komisioni vlerësues për vlerësimin e ofertave në projektin: **"Rregullimi i stadionit të futbollit në fshatin Xërxë"**, me Nr. prokurimi: **623.17.030.5-2-1**, në përbërje prej:
  1. Venhar Topalli, Kryesues
  2. Selami Shtërbani, anëtar
  3. Admirim Durguti, anëtar
- II. Komisioni ka për detyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të tenderit.
- III. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
- IV. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

*Me vendim të njoftohen:*

1. *Anëtarët e komisionit,*
2. *Zyra e Prokurimit dhe*
3. *Arkivi*





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office



Nr. protokollit 285  
Me datë: 19.07.2017  
Rahovec


Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të prokurimit publik, nenit 37 i Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurimin publik, nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

- I. Formohet komisioni vlerësues për vlerësimin e ofertave në projektin: "**Dezinsektimi, Dezinfektimi dhe Deratizimi**", me Nr. prokurimi: 623.17.005.2-2-1 të datës 17.07.2017, në përbërje prej:
  1. Qazim Cana , Kryesues
  2. Etnik Popaj, anëtar
  3. Ardian Rama, anëtar
- II. Komisioni ka për detyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të tenderit.
- III. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
- IV. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

*Me vendim të njoftohen:*

1. Anëtarët e komisionit,
2. Zyra e Prokurimit dhe
3. Arkivi





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office



Nr. protokollit 290  
Me datë: 24.07.2017  
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të prokurimit publik, nenit 37 i Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurimin publik, nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Formohet komisioni vlerësues për vlerësimin e ofertave në projektin: "**Furnizimi me material ushqimor dhe higjienik**", me Nr. prokurimi: **623.17.033.1-2-1**, të datës **19.07.2017** në përbërje prej:
  1. Fidan Hoti, Kryesues
  2. Muharem Morina, anëtar
  3. Selami Shtërbani, anëtar
- II. Komisioni ka për detyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të tenderit.
- III. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
- IV. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


*Me vendim të njoftohen:*

1. *Anëtarët e komisionit,*
2. *Zyra e Prokurimit dhe*
3. *Arkivi*





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office

Nr. protokollit 273  
Me datë: 19.07.2017  
Rahovec


Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr 1005 i datës 29.03.2017, nenit 4 par. 4 dhe nenit 21 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve me nr.1427 e datës 28.04.2017  
Kryetari i Komunës, merr:

**VENDIM**

- I. Me të cilin miratohet kërkesa e OJQ Iniciativa Pozitive nga Rahoveci, me Nr.prot. 2034 e datës 04.07.2017 për ndihmë momental.
- II. OJQ-së “ **Iniciative Pozitive**”, i ndahen mjetet materiale në shumë prej 250.00 € ( dyqind e pesëdhjetë euro), shumë të cilën ajo do ta shfrytëzojë për organizimin e dhurimit të gjakut në Rahovec.
- III. Ky vendim merret me qëllim të ofrimit të ndihmës, qytetarit në nevojë.
- IV. Mjetet do të sigurohen nga kodi i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

*Me vendim të njoftohen:*

1. OJQ “*Iniciativa pozitive*”, Rahovec,
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
3. Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
4. Arkivi.





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipal Rahovec  
Kryetari i komunës / Presednik Opštine / Municipal Mayor

01. 296  
Me dt. 26.07.2017  
Rahovec.

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës. Nr. 1005 të datës 29.03.2017 dhe në mbështetje të vendimit të Kuvendit të Komunës 01 Nr. 3118 i datës 31.08.2015, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- I. Me të cilin lejohet pagesa e mëditjeve anëtarëve të komisionit vlerësues për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë sipas vendimit të Kuvendit Komunal 01.Nr. 2290 të datës 30.05.2014 dhe atë si vijon:

| Nr. Rendor     | Emri dhe mbiemri                                  | Data e mbajtjes së Mbledhjes | Data e mbajtjes së Mbledhjes | Data e mbajtjes së Mbledhjes | Vlera e mëditjes | gjithsej |
|----------------|---|------------------------------|------------------------------|------------------------------|------------------|----------|
| 1              | Qazim Qeska                                       | 01.02.2016                   | 11.03.2016                   | 07.06.2016                   | 30.00€           | 90.00€   |
| 2              | Florije Boshnjaku                                 | 01.02.2016                   | 11.03.2016                   | 07.06.2016                   | 30.00€           | 90.00€   |
| 3              | Selim Duraku                                      |                              | 11.03.2016                   | 07.06.2016                   | 30.00€           | 60.00€   |
| <b>Totali:</b> | Për pagesën e mëditjeve për anëtarët e komisionit |                              |                              |                              | 240.00€          |          |

- II. Të njëjtëve pagesa e mëditjeve u lejohet sepse në datat e cekura në pikën I të këtij vendimi kanë punuar në vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale.
- III. Pagesa e mëditjeve për anëtarët e komisionit do të bëhet nga kodi buxhetor Mallra dhe Shërbime.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- V. Pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Me vendim të njoftohen:

1. Anëtarët e Komisionit
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe
3. Arkivi





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec/ Opština Orahovac/Municipal Rahovec  
Kryetari i komunës/Presednik Opstine/Municipal Mayor

01. 297  
Me dt. 26.07.2017.  
Rahovec.

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës. Nr. 1005 të datës 29.03.2017 dhe në mbështetje të vendimit të Kuvendit të Komunës 01 Nr. 3118 i datës 31.08.2015, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M


- I. Me të cilin lejohet pagesa e mëditjeve anëtarëve të komisionit vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë sipas vendimit të Kuvendit Komunal 01.Nr. 2290 të datës 30.05.2014 dhe atë si vijon:

| Nr. Rendor     | Emri dhe mbiemri   | Data e mbajtjes së Mbledhjes | Data e mbajtjes së Mbledhjes | Data e mbajtjes së Mbledhjes | Data e mbajtjes së Mbledhjes | Vlera e mëditjes | gjithsej |
|----------------|--|------------------------------|------------------------------|------------------------------|------------------------------|------------------|----------|
| 1              | Qazim Qeska  | 11.05.2017                   | 03.07.2017                   | 04.07.2017                   | 24.07.2017                   | 30.00€           | 120.00€  |
| 2              | Floriye Boshnjaku  | 11.05.2017                   | 03.07.2017                   | 04.07.2017                   | 24.07.2017                   | 30.00€           | 120.00€  |
| 3              | Selim Duraku   | 11.05.2017                   | 03.07.2017                   | 04.07.2017                   | 24.07.2017                   | 30.00€           | 120.00€  |
| <b>Totali:</b> | <b>Për pagesën e mëditjeve për anëtarët e komisionit</b> |                              |                              |                              |                              | <b>360,00€</b>   |          |

- II. Të njëjtëve pagesa e mëditjeve u lejohet sepse në datat e cekura në pikën I të këtij vendimi kanë punuar në vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale.
- III. Pagesa e mëditjeve për anëtarët e komisionit do të bëhet nga kodi buxhetor Mallra dhe Shërbime.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- V. Pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Me vendim të njoftohen:

1. Anëtarët e Komisionit
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe
3. Arkivi





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA  
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec  
Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office



Nr. protokollit 278  
Me datë: 12.07.2017  
Rahovec

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008, nenit 7 Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, me datë 01.12.2010, nenit 35 të Ligjit 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-17/2011), nenit 5 shkronja (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr. 03/-L068 dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ i MASHT Nr-08/2014 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues të datës: 25.02.2014, Kryetari i Komunës së Rahovecit në cilësinë e udhëheqësit më të lartë Administrativ pas shqyrtimit të raportit final të rekomanduar nga komisioni përzgjedhës i me nr.të protokollit 264 të datës 04.07.2017, për plotësimin e pozitës Drejtor i Shkollës së mesme të lartë “ **Ukshin Hoti** ” në fshatin Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, merr këtë:

**VENDIM**

**Për pranim në marrëdhënie pune**

- I. **z. Mustafa Hoti** nga fshati Krushë e Madhe, me nr. ID 1003196450 zgjidhet në vendin e punës **Drejtor i Shkollës së Mesme të lartë “ Ukshin Hoti ”** në fshatin Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit duke filluar punën nga data 12.07.2017.
- II. Marrëdhënia e punës themelohet për periudhën kohore të kontratës 4 vjeçare (katër vjeçare).
- III. Të përmendurit në pikën I të këtij vendimi i caktohet koeficienti 7.8 poenë.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim dhe zyra e personelit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Arsyetim**

Duke u bazuar në raportin final dhe rekomandimin e bërë nga Komisioni përzgjedhës, gjatë intervistimit të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin e shpallur nga Drejtoria e Arsimit në gazetën Epoka e Re me datë 07.06.2017 me numër protokollit Nr. 07/693 për plotësimin e vendit të lirë të punës si drejtor në Shkollën së mesme të lartë “ Ukshin Hoti ” në Krushë të Madhe dhe në bazë të pikëve të fituara nga komisioni intervistues si dhe pas zbatimit të plotë të procedurës së rekrutimit në të cilën ka aplikuar z. Mustafa Hoti u vendos që Drejtor i Shkollës së mesme të lartë “ Ukshin Hoti ” në fshatin Krushë e Madhe të zgjidhet z. Mustafa Hoti nga fshati Krushë e madhe.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë komisionit për ankesa në Komunën e Rahovecit, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

*Me vendim të njoftohen:*

1. *I punësuari Mustafa Hoti*
2. *Drejtoria e Arsimit*
3. *Zyra e Personelit dhe*
4. *Arkivi*







Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac /Municipal Rahovec



**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office**

Nr.protokolit 266  
Me datën: 10.07.2017  
Rahovec

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës , merr këtë :

**V E N D I M**

- I. Formohet komisioni për pranimin teknik të punimeve sipas kontratës “Riparimi dhe Adaptimi i QKMF-së” me nr. të prokurimit 623.15.045.521, në përbërje:
  1. Shpejtim Mustafa- Kryesues
  2. Qazim Cana - anëtar
  3. Sylejman Daka - anëtar
- II. Komisioni ka për detyrë të bëjë pranimin teknik të punimeve sipas kontratës të cekur në pikën I të këtij vendimi.
- III. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij Vendimit.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit .

Me Vendim të njoftohen :

1. Anëtar të komisionit
2. DSHPS
3. Arkivi





Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Mayor Office

Nr. protokollit 271  
Me datë: 11.07.2017  
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr:

**VENDIM  
PËR VAZHDIMIN E ORARIT TË PUNËS**

- I. Vazhdohet orari i punës për zyrtarët e Zyrës së Gjendjes Civile, zyrtarët e Zyrës së Pranimit dhe zyrtarët e Tatimit në Pronë të Komunës së Rahovecit dhe atë për çdo ditë pune prej orës 16:00 deri në ora 18:00, ndërsa të shtunën prej orës 09:00 deri në ora 12:00.
- II. Vendimi do të vlejë prej 17 korrikut deri me 25 gusht 2017.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Administratë të përgjithshme dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

*Me vendim të njoftohen:*

1. Drejtoria për Administratë të Përgjithshme,
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
3. Arkivi.

